

PROGRAMI PËR RIMËKËMBJEN E RRËQEBULLIT TË BALLKANIT

Newsletter


ÇËSHTJET KRYESORE

Fq. 1 | Sfida të reja për ruajtjen e rrëqebullit të Ballkanit

Fq. 3 | Qentë endacakë të zonave rurale dhe jeta e egër

Fq. 4 | Mbreti i Munellës

Fq. 5 | Rrëqebulli i Ballkanit në kongresin e MES



SFIDA TË REJA PËR RUAJTJEN E RRËQEBULLIT TË BALLKANIT

Nga Manuela von Arx

Programi për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit, filloi projektin më të ri në muajin Shtator. Ashtu si dhe është përmendur vazhdimisht edhe në publikimet e mëparshme, pavarësisht përpjekjeve tona, statusi i ruajtjes së rrëqebullit të Ballkanit mbetet shqetësues. Për këtë arsye, gjatë pesë viteve të ardhshme, programi synon analizimin e mëtejshëm dhe reduktimin e faktorëve që çojnë në rënie të popullatës së tij. Përmirësimi i kushteve të jetesës për rrëqebullin e Ballkanit, si habitati dhe preu, është një linjë veprimi, ndërkohë ulja e vdekshmërisë së shkaktuar nga njerëzit përmes rritjes së ndërgjegjësimit dhe zbatimit të ligjit është një tjetër linjë. Të gjitha këto ne nuk mund t'i arrijmë vetëm, prandaj është e nevojshme përfshirja e autoriteteve kompetente, grupeve përkatëse të palëve të interesit, komuniteti lokal si dhe publiku i gjerë.

Për më tepër, duke patur parasysh që madhësia e popullatës së rrëqebullit të Ballkanit ka qenë shumë e vogël për dekada tashmë, ndryshueshmëria e ulët gjenetike është një tjetër çështje shumë shqetësuese. Jemi përballë shumë pyetjeve në lidhje me statusin gjenetik të rrëqebullit të Ballkanit dhe çfarë do të thotë në të vërtetë për rimëkëmbjen e popullatës së tij.



Në mungesë të ekspertizës në grupin tonë të punës, ne organizuam një seminar me pjesëmarrjen e një grupi ekspertësh të gjenetikës, të cilët punojnë mbi rrëqebullin e Ballkanit, ku dhe diskutuam tema të rëndësishme me qëllim marrjen e përgjigjeve për pyetjet e ngritura në lidhje me këtë çështje. Ky seminar u zhvillua në datat 2–3 nëntor 2022 në Emmental, Zvicër (shih foton). Programi përbëhej nga disa prezantime hyrëse si dhe diskutime përkatëse për secilën tematikë.

Si përfundim, për shkak të izolimit afatgjatë dhe numrit të vogël të individëve, popullata e rrëqebullit të Ballkanit ka ndryshueshmërinë më të ulët gjenetike nga të gjitha popullatat e rrëqebullit euroaziatik. Numri i individëve që kontribuojnë në riprodhim (e ashtuquajtura madhësia efektive e popullatës N_e) mund të jetë deri në 11 rrëqebuj. Popullata tashmë shfaq një nivel të lartë të erozionit gjenetik (çiftimit të individëve të lidhur ngushtë nga ana gjenetike) në krahasim me popullatat e tjera të rrëqebullit në Evropë dhe dyshohet se ai tashmë mund të vuajë nga depresioni i erozionit gjenetik, i cili mund të shfaqet si ulje e rezistencës ndaj sëmundjeve dhe /ose duke reduktuar fertilitetin e individëve. Duke patur parasysh këto rezultate, programi po konsideron përforsimin e popullatës së rrëqebullit të Ballkanit, e cila do të analizohet në vazhdim përgjatë implementimit të projektit.





© MES/BLRP



© MES/BLRP

QENTË ENDACAKË TË ZONAVE RURALE DHE JETA E EGËR

Nga Aleksandar Pavlov

Kur lihen në natyrë, qentë endacakë ndikojnë thellësisht në jetën e egër. Të stresuar dhe të frikësuar, instikti i mbijetesës fillon duke i shtyrë ata të bëhen të egër. “Gjurma” e tyre ekologjike është aktualizuar në disa mënyra. Së pari, qentë, në kërkim të ushqimit, sulmojnë kafshët e egra, individualisht ose në tufa. Së dyti, ata shpesh ushqehen me kafshët e ngordhura që kanë rënë pre e grabitqarëve të pyjeve. Kjo ndikon edhe te rrëqebulli i Ballkanit, duke ushtruar presion shtesë mbi këtë lloj të rrezikuar në mënyrë kritike. Së treti, qentë endacakë priren të çiftohen me ujqërit. Një kryqëzim i tillë ndikon tek informacioni gjenetik i ujqërve, një kafshë e cila është thelbësore në ruajtjen e ekuilibrit natyror midis grabitqarit dhe preut. Një efekt tjetër konsiderohet dhe shqetësimi i përgjithshëm në jetën e egër, duke bërë që kafshët që banojnë në pyll të shmangin zonat ku qentë endacakë janë të pranishëm.

Situata me qentë endacakë në zonat rurale të Maqedonisë së Veriut është një çështje që duhet të trajtohet urgjentisht. Shpeshherë në terren, ne shikojmë që qentë në natyrë janë bërë tashmë të zakonshëm. Nuk është e rrallë që në shtigjet malore në rajonet e Prespës, Mavrovos dhe Malit Sharr mund të hasen qen të braktisur. Për të trajtuar këtë çështje problematike, në Gusht të këtij viti, Shoqata Ekologjike Maqedonase (MES) organizoi një forum diskutimi mbi Qentë endacakë të zonave rurale.

Qëllimi i këtij forumi ishte fillimi i një debati më të gjerë midis institucioneve dhe OJQ-ve maqedonase mbi ndikimin e qenve endacakë në jetën e egër. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Ndërmarrja Publike Laika për Mirëqenien e Kafshëve Endacake, Shoqata për Mbrojtjen e Kafshëve Anima Mundi dhe MES. Gjithashtu, në audiencë kishte edhe përfaqësues të tjerë nga organizatat për mbrojtjen e kafshëve, të cilët iu bashkuan diskutimit. Pjesëmarrësit u njohën me ndikimin e gjerë që kanë qentë endacakë në jetën e egër dhe të gjithë ranë dakord që faktorët kryesorë që kontribuojnë për këtë problem janë pronësia e papërgjegjshme e qenve dhe sistemi i dobët i shpëtimit të kafshëve. Pas shkëmbimit të ideve, dolëm në përfundimin që problemi kërkon një zgjidhje sistematike që përfshin të gjithë aktorët kryesorë. Në këtë drejtim, duhet të ketë një plan veprimi që të përcaktojë masat konkrete, periudhën kohore të zbatimit dhe institucionet përgjegjëse.

Forumi ishte vetëm një hap i parë drejt një qasjeje më gjithëpërfshirëse në trajtimin e çështjes së qenve endacakë. Është tashmë e ditur që ndikimi i qenve endacakë në jetën e egër është i rëndësishëm dhe, për rrjedhojë, përpjekjet ruajtëse duhet të marrin në konsideratë këtë aspekt gjatë monitorimit dhe rimëkëmbjes së popullatës së rrëqebullit të Ballkanit.

MBRETI I MUNELLËS

*Nga Marianne Graf
Presidente e "Partneritetit Austri-Shqipëri"
Konsull Nderi i Shqipërisë në Austri*

*Cili mbret mund të mburret kur sheh skulpturën e tij në një kullë vrojtimi të lartë mbi një peizazh malor jashtëzakonisht romantik? Vetëm mbreti i Munellës, rrëqebulli i Ballkanit, *Lynx lynx balcanicus*, një nga macet më të rralla në planetin Tokë.*



© PPNEA/BLRP

Një skulpturë e rrëqebullit të Ballkanit u vendos së fundmi në majë të një kulle në fshatin Gurth-Spaç, në rajonin e Mirditës, Shqipëri. Më datë 4 nëntor, me qëllim përrurimin e saj, u organizua një ceremoni, ku morën pjesë stafi i PPNEA, autoritetet lokale, guidat turistike si dhe komuniteti lokal. Statuja e rrëqebullit të Ballkanit është një nismë e filantropistes znj. Marianne Graff, Presidente e "Partneritetit Austri-Shqipëri". Ajo punoi së bashku me Turi Nikollin, një skulptor vendas, për dizejimin e kësaj kryevepre, që të rezultonte sa më e denjë për një sundimtar si rrëqebulli i Ballkanit.

Skulptura e rrëqebullit të Ballkanit luan disa role të rëndësishme. Së pari, shërben si referencë për llojin, popullata e të cilit kërcënohet me zhdukje për shkak të gjuetisë së paligjshme, shpyllëzimit, zjarreve masive të kohëve të fundit në pyje dhe ndërhyrjeve të tjera që dëmtojnë habitatin. Së dyti, duhet theksuar se zona e Munellës, ku ky lloj është i pranishëm, është caktuar nga qeveria si Zonë e Mbrojtur, por është e domosdoshme një përmirësim i statusit të mbrojtjes për malet e egra të Munellës, të cilat konsiderohen unike në Evropë.

Për më tepër, shkencëtarët, studiuesit, stafi i organizatave të ruajtjes së natyrës si dhe ata që janë të dhënë pas natyrës dhe biodiversitetit, mund të përdorin këtë zonë për të shkëmbyer njohuri profesionale dhe teknike rreth florës dhe faunës së vendit, për të zhvilluar strategji ruajtje të llojit si dhe mundësi për bashkëpunim ndërkuftar. Së fundmi, të gjithë mund të vizitojnë "Eco-Nature Destination Gurth-Spaç", e cila shërben dhe për sigurimin e të ardhurave për fermerët e vegjël të fshatit dhe krijon mundësi për një jetesë të qëndrueshme.

Pavarësisht se banori i turpshëm i malit rrallë mund të shihet, ekspertët e rrëqebullit të PPNEA-s mund të ju tregojnë foto nga kamerat kurth, por gjithashtu prania e tij mund të ndihet ndërsa ngjiteni në malin e Munellës gati 2000 m të lartë, ku gjenden ende disa pjesë të paprekura të pyjeve të ahut dhe formacione të veçanta karstike. Kushdo që e shijon ditën me gatime tradicionale të rajonit dhe nën dritën e zjarrit për të përjetuar lindjen e diellit në ballkonin natyror të Mirditës në mëngjes, sigurisht që e ka gjetur zemrën dhe mallin e tij në Gurth-Spaç, rajonin e Mirditës.



© PPNEA/BLRP

RRËQEBULLI I BALLKANIT NË KONGRESIN E MES

Nga Aleksandar Pavlov



Në Tetor të këtij viti, Shoqata Ekologjike Maqedonase organizoi Kongresin e 6-të të Ekologëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut me pjesëmarrje ndërkombëtare. Kongresi, që përkon me 50-vjetorin e themelimit të MES, priti më shumë se 100 të ftuar nga 12 vende të rajonit dhe më gjerë. Gjatë këtij event, shkencëtarët prezantuan gjetjet e tyre kërkimore në një sërë tematikash, duke përfshirë biodiversitetin dhe ruajtjen e natyrës.

Ekipi i BLRP gjithashtu mori pjesë në Kongres, duke prezantuar punën për ruajtjen e maces më të rrezikuar në Ballkan, rrëqebullin e Ballkanit. Prezantimi “Ruajtja e rrëqebullit të Ballkanit” i anëtarit të ekipit tonë, Dime Melovski, dha një pasqyrë të situatës aktuale, duke filluar me historinë e shkurtër të llojit dhe duke vazhduar tek kërcënimet aktuale, trendin e popullatës dhe kërkimet në terren të preut të tij dhe preferencat e habitatit. Ndërsa, prezantimi mbi vlerësimin e dendësisë dhe shkallës së ndryshimit të gjeneratës së rrëqebullit të Ballkanit dhe gjitarëve të tjerë, dha një pamje të tredeve të popullatave të gjitarëve të pyllit, si rezultat i punës 14-vjeçare në terren me kamera-kurth.



PROGRAMI PËR RIMËKËMBJEN E RRËQEBULLIT TË BALLKANIT

Balkan Lynx Recovery Programme (BLRP)

“Programi për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit” (BLRP) është një iniciativë e përbashkët që implementohet nga Fondacioni EuroNatur, KORA (Shoqata e Ekologjisë së Mishngrënësve dhe Menaxhimi i Jetës së Egër në Zvicër), MES (Shoqata Ekologjike Maqedonase), PPNEA (Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri) dhe ERA (Grupi i Veprimit me Përgjegjësi Mjedisore).

Informacion shtesë:
<https://www.facebook.com/balkanlynx>



Environmentally
Responsible
Action



PPNEA

PROTECTION AND PRESERVATION OF NATURAL ENVIRONMENT IN ALBANIA
• SINCE 1991 •



MACEDONIAN
ECOLOGICAL
SOCIETY



RAUBTIERÖKOLOGIE UND WILDTIERMANAGEMENT

euRONATUR